

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyctarin Enes Mehmeti , ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Shtime, të cilin e përfaqëson avokati [REDACTED] nga Prishtina, kunder te paditurës [REDACTED] nga Fushë Kosova rr.' [REDACTED], per kompensimin e dëmit, me date 30.09.2016, jashte séance ka marre kete:

A K T G J Y K I M
-pa shqyrtim kryesor te cështjes -

- I. **REFUZOHET**, ne teresi si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Shtime, me te cilen ka kerkuar qe te detyrohet e padituri t'ia kompensojë dëmin materiale, në bazë të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, dëm të cilin e paditura i'a ka kompensuar paditësit në bazë të marrveshjes jashtë gjyqësore të datës 04.03.2016 në shumë prej 1,095.00€.
- II. **OBLIGOHET** paditesi që të paguan taksën gjyqesore per padi dhe aktgjykim ne shume prej 37,50€, pas pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenimin e pasojave juridike.

A r s y e t i m i

Paditesi ka ushtruar padi kunder te paditurës, me pretendimin se per shkak te veprimeve deliktore te [REDACTED], i cili në momentin e aksidentit nuk ka pasur policë të sigurimit, ku nga ky aksident ka pesuar deme materiale.

Gjykata, pasi qe ka shqyrtuar shkresat e lendet, ka obliguar te paditurën qe te parashtrojë përgjigje në padine e paditesit. E paditura ne perjigjen e saj ne padi, ka paraqitur prova te vlefshme, të cilat vërtetojn theksimet e saj në përgjigje në padi, e cila është e bazuar në Ujdin Gjyqësore të datës 04.03.2016, që e paditura ka arritur me paditësin për kompensimin e dëmit, me anë të së cilës paditësit i ka bërë kompensim e të hollave në vlerë prej 1,095,00€. Andaj mbi kete baze nuk ekzistojn pretendimet e padise dhe per pasoje e njejta ka rezultuar si e pathemelt.

Nga sa u tha me siper eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi duke u bazur ne nenet 152, 399 lidhur me 143 te LPK-se.

Per shpenzimet e procedures, gjykata ka vendosur ne baze te UA nr.2008/2 te KGJK-se, per unifikimin e taksave gjyqesore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.447/16, me datën 30.09.2016



Gjyktari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa në afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne Gjykaten e Apelit ne Prishtine, perms kesaj Gjykate.

